



REPUBLIKA E KOSOVËS / REPUBLIKA KOSOVA

GJYKATA THEMELORE FERIZAJ

Numri i lëndës: 2021:233546

Datë: 31.03.2023

Numri i dokumentit: 04148388

2021:233547

NË EMËR TË POPULLIT

GJYKATA THEMELORE NË FERIZAJ – Departamenti i Përgjithshëm, gjyqtari i vetëm gjykues Imri Sejda, me bashkëpunëtorin profesional Driton Ahmeti, në çështjen penale kundër të akuzuarve Xh.A. dhe H..A., të akuzuar se në bashkëkryerje kanë kryer veprën penale vjedhja e pyllit nga neni 349 par.1 lidhur me nenin 31 të KPRK-së, sipas aktakuzës së Prokurorisë Themelore në Ferizaj – Departamenti i Përgjithshëm PP.II.nr.1575/21 e datës 18.10.2021, pas mbajtjes së shqyrtimit fillestar publik me datat 06.03.2023, në prani të prokurorit të shtetit Besnik Nuredini, përfaqësuesi i palës së dëmtuar nga Drejtoria për Zhvillim Ekonomik – Shtime T.H.si dhe të akuzuarve, të njëjtën ditë mori dhe publikisht komunikoi, ndërsa me datë 30.03.2023, përpiloi me shkrim këtë:

A K T G J Y K I M

Kundër të akuzuarve:

- XH.A.**, nga i ati H....., e ëma T....., e gjinisë H....., i lindur me dt....., në me vendbanim në fshatin K Shtime, me numër personal, ka të kryer shkollën e mesme, i martuar, baba i tre fëmijëve, i pa punë, i gjendjes së dobët ekonomike, shfrytëzues i ndihmave sociale(shih kartonin nr..... nga QPS Shtime i dt.11.09.2022), shqiptar, shtetas i Republikës së Kosovës, i dënuar më parë për veprë të njëjtë penale, ndaj tij nuk zhvillohet ndonjë procedurë tjetër penale.
- H..A.**, nga i ati Xh.., e ëma Z., e gjinisë B., i lindur me dt....., P....., me vendbanim në fshatin ... K Shtime, me numër personal, ka të kryer shkollën fillore, i pa martuar, punëtor, i gjendjes së dobët ekonomike, jem shfrytëzues i ndihmave sociale (shih kartonin nr..... nga QPS Shtime i dt.11.09.2022,i cili është i evidentuar në emër të babait tim), shqiptar, shtetas i Republikës së Kosovës, i dënuar më parë veprë të njëjtë penale, ndaj tij nuk zhvillohet ndonjë procedurë tjetër penale.

JANË FAJTOR

- me datë 21.09.2021 rreth orës 07:05, në pyllin publik në Rajonin Ekonomik Pyjor në fsh..., K. Shtime, në paralelen 10, në vendin e quajtur "K.B.", në bashkëkryerje me qëllim të përvetësimit të pasurisë së huaj të luajtshme e që vetit t'i sjellin dobi pasurore të kundërligjshme, kanë vepruar në kundërshtim me dispozitat e Ligjit nr. 2003/3 për Pyjet e Kosovës, në atë mënyrë që duke përdorë sharrë motorike kanë prerë 32 copa dru të njoma të llojit ah, plepi dhe qarri, me diametër 14-24 cm, të gjata 11-16 m, me vëllim të përgjithshëm 3,58 m3, ku masën drusore nga vendi i ngjarjes e kanë tërhequr me dy kuaj dhe me të arritur te vendi i quajtur "L.A." i kanë ngarkuar në traktor, me ç' rast Drejtorisë për Zhvillim Ekonomik-Njësia e Pylltarisë në Shtime, i ka shkaktuar dëm në vlerë prej 396,14 €,

- **Me këtë në bashkëkryerje kanë kryer veprën penale Vjedhja e pyllit nga neni 349 par. 1 lidhur me nenin 31 të KPRK-së.**

Andaj gjykata në bazë të neneve 4, 7, 17, 21, 31, 39, 44, 46, 47, 48, 49, 69, 70 dhe 349 par.1 të Kodit Penal të Republikës së Kosovës (KPRK),si dhe neni 364, 452, 462 të Kodit të Procedurës Penale të Republikës së Kosovës (KPPRK), të akuzuarit i :

GJYKON

Të pandehurin e parë

Me dënim me dënim në gjobë në shumën prej 300 € / treqind euro/, dënimin e shqiptuar me gjobë do ta paguaj në afat prej 30 ditësh, nga dita e plotfuqishmërisë së këtij aktgjykimi, e në rast se i akuzuari nuk e paguan dënimin me gjobë në asnjë mënyrë, sipas nenit 43 par. 3 të KPK-së, i njëjti dënim do t'i shndërrohet në dënim me burgim ashtu që për çdo 20 Euro, do t'i llogaritet një (1) ditë burgim.

Të pandehurin e dytë

Me dënim me dënim në gjobë në shumën prej 200 € / dyqind euro/, dënimin e shqiptuar me gjobë do ta paguaj në afat prej 30 ditësh, nga dita e plotfuqishmërisë së këtij aktgjykimi, e në rast se i akuzuari nuk e paguan dënimin me gjobë në asnjë mënyrë, sipas nenit 43 par. 3 të KPK-së, i njëjti dënim do t'i shndërrohet në dënim me burgim ashtu që për çdo 20 Euro, do t'i llogaritet një (1) ditë burgim.

Të pandehurit konform nenit 452 paragrafi 4 të KPPRK-së, lirohen nga detyrimi i kompensimit të shpenzimeve të paushallit gjyqësor dhe nga obligimi për kompensim të Viktimave të Krimit, meqenëse të njëjtit e kanë gjendjen e dobët ekonomike, janë shfrytëzues të asistencës – ndihmës sociale (shih. - shih kartonin nr.... nga QPS Shtime i dt.11.09.2022) dhe pagesa e këtyre shpenzimeve do të vështirësonte edhe më tepër gjendjen e tyre ekonomike.

E dëmtuara Drejtoria për Zhvillim Ekonomik – Shtime, për realizimin e kërkesës pasurore juridike, udhëzohen në kontest civil.

A r s y e t i m i

Historiku procedural

Prokuroria Themelore në Ferizaj - Departamenti i Përgjithshëm, me aktakuzën e saj PP.II.nr.1575/21 e datës 18.10.2021, ka ngarkuar të akuzuarit, për bashkëkryerje të veprës penale vjedhja e pyllit nga neni 349 par.1 lidhur me nenin 31 të KPRK-së, dhe ka kërkuar që të akuzuarit të shpallen fajtor dhe t’iu shqiptohet sanksioni penal i paraparë me ligj.

Gjykata pasi studioi materialet e çështjes penale te paraqitur për gjykim, çmoi se çështja është në juridiksionin e saj dhe gjykimi i kësaj çështje penale duhet të realizohet përpara kësaj gjykate. Po kështu është në kompetencën lëndore dhe territoriale të kësaj Gjykate, pasi veprat penale për të cilën janë proceduar për të pandehurit gjykohet nga gjyqtari i vetëm gjykues dhe vendi ku është kryer ose tentohet të kryhet vepra penale.

Gjykata duke vepruar sipas kësaj akuze, caktoi dhe mbajti shqyrtimin fillestar me datë 06.03.2023 në të cilën prokurori i shtetit, lexoj aktin akuzues dhe gjyqtari pasi që u bind se i pandehuri e ka kuptuar akuzën, konform nenit 241 par.4 të KPPK-së, të pandehurit ju ofroj mundësinë të pranojnë fajësinë ose të deklarojnë të pafajshëm.

I pandehuri Xh.A. në shqyrtimin fillestar publik ka deklaruar se: e pranoj fajësinë se në bashkëkryerje kam kryer veprën penale Vjedhje pylli nga neni 349 par.1 lidhur me nenin 31 të KPRK-së, jam i njoftuar me pasojat e pranimin të fajësisë, pranimin e bëj në mënyrë vullnetare, ndihem thellë i penduar, e di që po gaboj që po shkoj në mal, por këtë po e bëjë për shkak të kushteve të vështira ekonomike po detyrohem që nganjëherë të shkoj të marr dru dhe ti shes ato për të siguruar ekzistencën e familjes sime ngase burim i të ardhurave në familjen time gjashtë anëtarësh nuk kemi përveç një ndihmë sociale që e shfrytëzojmë, premtoj se në të ardhmen do të

mundohem që mos të shkoj më në mal për të marr dru pa leje ngase po e shoh që nga kjo nuk kam ndonjë të mirë, krejt në fund lus gjykatën që mundësisht të më shqiptoj ndonjë dënim sa më të butë që është e mundur.

I pandehuri Xh.A. në shqyrtimin fillestar publik ka deklaruar se: e pranoj fajësinë se në bashkëkryerje kam kryer veprën penale Vjedhje pylli nga neni 349 par.1 lidhur me nenin 31 të KPRK-së, jam i njoftuar me pasojat e pranimin të fajësisë, pranimin e bëj në mënyrë vullnetare, ndihem thellë i penduar, e di që kam gabuar që kam shkuar në pyll për të marr dhe prerë dru pa leje së bashku me prindin tim, por këtë e kemi bërë për shkak të kushteve të vështira ekonomike që i kemi në familje, unë jam duke punuar ndonjëherë punë private kur të gjej por jo rregullisht dhe në fund lus gjykatën që mundësisht të më shqiptoj ndonjë dënim sa më të butë që është e mundur.

Gjykata lidhur me pranimin e fajësisë nga të pandehurit për veprën penale për të cilën akuzohen, në bazë të nenit 242 paragrafi 5 të KPPK-së, mori pikëpamjet e prokurorit të shtetit, i cili deklaroj se pajtohem me pranimin e fajësisë nga ana e të akuzuarve është bërë konform dispozitat e nenit 242 të KPPK-së, pranimin e fajësisë është bërë në mënyrë vullnetare duke u mbështetur në prova dhe fakte që i përmban aktakuza, andaj i propozoj gjykatës që të akuzuarit ti shpall fajtor dhe të ju shqiptoj sanksion penale sipas ligjit.

Gjykata për të vlerësuar pranimin e fajësisë shqyrtoi me kujdes kushtet e parapara nga neni 242 par. 2 të KPPK-së dhe me këtë rast vlerësoi se të pandehurit kanë kuptuar natyrën dhe pasojat e pranimin të fajësisë, pranimin e fajit e kanë bërë vullnetarisht, pranimi i fajit nuk është rezultat i përdorimit të forcës, kërcënimeve apo premtimeve, se aktakuza nuk përmban asnjë shkelje të qartë ligjore ose gabime faktike, pranimi i fajit mbështetet në fakte dhe prova materiale të rastit konkret dhe atë me provat e paraqitura nga Prokurori i Shtetit siç janë: Fletëparaqitja e rojës së pyllit nr. ditarit..../21, të datës 21.09.2021, dhe me numër .../2021, të datës 08.10.2021, Foto dokumentacioni, si dhe shkresa tjera në lëndë.

Meqenëse të pandehurit e kanë pranuar fajësinë e cila është në përputhje me kriteret e përshkruara më lartë, gjykata në bazë të nenit 242, paragrafi 6, të KPPK-së, ka vlerësuar se nuk është e nevojshme vërtetimi i ndonjë fakti relevant për shqiptimin e dënimit dhe për këtë arsye ka vazhduar me shqiptimin e dënimit. *(nëse i pandehuri në shqyrtim fillestar pranon fajësinë dhe kryetari i trupit gjykues vlerëson se pranimi i fajit është bërë në pajtim me ligjin mund të vazhdoj procesin me shqiptimin e dënimit pa plotësuar trupin gjykues dhe pa e mbajtur fare*

shqyrtimin gjyqësor, lidhur me këtë shih mendimin juridik të gjykatës supreme të evidentuar si GJA nr.207/13 të dt.19.03.2013).

Duke vlerësuar në aspektin juridik, gjykata gjeti se në veprimet e të pandehurve ekzistojnë të gjitha tiparet objektive dhe subjektive të veprës penale në bashkëkryerje vjedhja e pyllit nga neni 349 par.1 lidhur me nenin 31 të KPRK-së, ashtu siç është theksuar në dispozitiv të këtij aktgjykimi, në të cilin është përshkruar data, vendi, koha dhe mënyra apo rrethanat e kryerjes së veprës penale për çka dhe të pandehurit u shpallën fajtor dhe ju shqiptua dënim siç është theksuar në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

Me rastin e matjes dhe caktimit të llojit dhe lartësisë së dënimit për të pandehurit, gjykata vlerësoj rrethanat në kuptim të nenit 69 dhe 70 të KPRK-së dhe gjeti si rrethanë veçanërisht lehtësuese se të pandehurit e kanë bërë pranimin e fajësisë, janë penduar për veprën penale të kryer, premtimin se në të ardhmen nuk do të përsërisin vepra të tilla apo të ngjashme, se jetojnë në gjendje të rëndë ekonomike janë shfrytëzues së asistencës sociale shih kartonin nr..... nga QPS Shtime i dt.11.09.2022, ndërsa rastin konkret si rrethana renduese gjeti se të pandehurit edhe më parë kanë qenë të dënuar me aktgjykime të formës së prerë për vepra të njëjta penale dhe atë që të dy me aktgjykimet nr. 2019:.... i datës 25.05.2021 dhe 2020:.... i datës 11.12.2022, etj. dhe përveç kësaj vlerësoi edhe shkallën e përgjegjësisë penale të pandehurve si dhe rrezikshmërinë konkrete të veprës penale.

Gjykata është e bindur se edhe me një dënim të tillë, duke marrë parasysh edhe faktin se të pandehurit kanë bërë pranimin e fajësisë do të arrihet qëllimi i dënimit i paraparë në nenin 38 të KPRK-së, përkatësisht dënimi i shqiptuar është plotësisht i justifikueshëm, në përshtatje me rrethana te kryerjes, rrezikshmërisë së saj dhe autorëve të saj, që do të shërbej në parandalimin e kryesit nga kryerja e veprave penale në të ardhmen (preventiva speciale) si dhe do të arrihet qëllimi ti përmbaj personat tjerë nga kryerja e veprës penale (preventiva gjenerale).

Vendimi për kërkesën pasurore-juridike, është marr në kuptim të nenit 462 par. 1 dhe 2 të KPPRK-së.

Vendimi mbi lirimin nga shpenzimet paushallë dhe shpenzimet e procedurës dhe për kompensimin e viktimave të krimit është marr në kuptim të dispozitës së nenit 452 par.4 të KPRK-së.

Në bazë të theksuarave më lartë u vendos si në dispozitivit të këtij aktgjykimi.

GJYKATA THEMELORE FERIZAJ
DEPARTAMENTI PËRGJITHSHËM, DIVIZIONI PENAL
2021:233547 e datës 30.03.2023

Bashkëpunëtori profesional:
Driton Ahmeti

Gjyqtari i vetëm gjykuese:
Imri Sejda

KËSHILLA JURIDIKE: Kundër këtij aktgjykimi palët kanë të drejtë ankese në Gjykatën e Apelit në Prishtinë, në afat prej tridhjetë (30) ditësh, llogaritur nga dita e pranimi të tij. Ankesa dorëzohet përmes kësaj Gjykate, në kopje të mjaftueshme për palët dhe Gjykatën.